



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.21.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
SHTËRPCËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtërpcës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësja e ekipit Svetlana Peroviq dhe anëtari Mehmet Kurti, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Luljeta Morina.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	25
5 Qeverisja e mirë.....	26
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	29
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	32
Shtojca III: Letër konfirmimi	38

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të komunës së Shtërpcës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 16/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës së Shtërpcës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se informatat e shpalosura në pasqyrat financiare lidhur me pasuritë nuk janë të sakta.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017**

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e vitit 2017. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunes së Shtërpçës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të Komunës së Shtërpcës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Regjistri i pasurisë fikse nuk e konfirmon gjendjen e plotë të pronës, sepse ai përmban pasurinë që është tjetërsuar. Vlera totale e pasurisë që nuk është më në pronësi të komunës, e cila u tjetërsua gjatë vitit 2017, kishte vlerë prej 13,020€ në librin kryesor;
- Komuna e ka regjistruar gabimisht tokën e komunës, si pasuri jo kapitale në vlerë prej 13,708€ dhe për të njëjtën shumë ka mbivlerësuar pasurinë nën 1,000€ në PFV; dhe
- Komuna në regjistrin e pasurisë nuk ka regjistruar pronën komunale-tokat, 113 parcela , dhe donacionet/pasuritë që janë përfituar nga financimi i ministrive.

Opinionin jonë nuk është i modifikuar (kualifikuar) për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Shtërpçës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të

auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Kërkohet që komuna të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve;
- Raportet tremujore përfshirë edhe raportin nëntëmujor;
- Raportet operative (të performancës); dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit më kohë.

Në Memorandumin tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 21 dhjetor 2017, ne kemi ngritur disa çështje në lidhje me kornizën e raportimit. Çështjet e ngritura nuk u adresuan plotësisht nga menaxhmenti komunal. Si rrjedhojë, në versionin e parë të PFV-ve të dorëzuara në MF në datën 24/01/2018 ishte e nevojshme të bëhen disa korrigjime financiare në nenin 10, në shënimet 9 dhe 17.

Më gjithë përmirësimet e bëra, PFV-të ende kishin disa gabime, kryesisht të shpalosjet e pasurisë, të cilat në detaje i kemi prezantuar tek theksimi i çështjes të opinionit auditimit.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, komuna kishte përgatitur të gjitha raportet më përjashtim të raportit vjetor të performancës, që është kërkesë ligjore e komunës.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për mos adresimin e rreziqeve të rëndësishme lidhur me plotësinë e pasurisë. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të siguruar vlerësimin e saktë të pasurive kapitale.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë si dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në fushën e MFK-së, prokurimi vazhdon të mbetet fusha ku janë identifikuar shumë dobësi, dhe nuk është e sigurt se është arritur vlera për parane e shpenzuar. Kontrollët mbi realizimin e të hyrave dhe investimeve duhet të shtohen me qëllim që komuna të realizojë ato në një përqindje më të lartë kundrejt mundësive të saj, që si rezultat do të realizohen me shumë projekte për qytetarët. Gjithashtu, kontrollët mbi të hyrat nuk janë tërësisht të përshtatshme dhe nuk zbatohen në mënyrë efektive, veçanërisht në rastin e mbledhjes së të hyrave, gjë që rezultoi në një rritje të të arkëtueshmeve. Fushat kryesore tjera ku nevojiten kontrole të shtuara janë shpenzimet për mallra dhe subvencione.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	3,577,609	3,725,964	3,368,668	3,030,104	3,455,103
Granti i Qeverisë -Buxheti	3,130,695	3,169,163	3,146,646	2,824,762	3,192,280
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	109,887	93,690	177,512	84,844
Të hyrat vetjake ³	446,914	446,914	128,332	27,830	177,979

Raporti në mes të shpenzimeve të realizuara dhe buxhetit ka treguar se realizimi i shpenzimeve nuk është në nivelin e përputhje me buxhetin e planifikuar. Parashikimi dhe planifikimi jo adekuat i buxhetit kanë ndodhur për shkak të faktit se buxheti fillestar nuk përfshinë planifikimin e shpenzimeve nga të hyrat vetjake të pa shpenzuara të transferuara nga vitet e mëparshme, ndërsa

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

shpenzimi nga ky burim është regjistruar si real. Gjithashtu, buxheti fillestar përfshin planifikimin e shpenzimit të të hyrave vetjake të vitit aktual, të cilat nuk janë realizuar në nivelin e planit.

Nga kjo ka sjell deri ne situatën që buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar u rrit për 148,355€ apo 4%. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti 2016 në vlerë prej 109,887€ dhe shuma e marrë nga qeveria për shlyerjen e deficitit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në vlerë 38,468€.

Shpenzimet buxhetore në vitin 2017 ishin në nivelin 90% të buxhetit final ose 3,368,668€, me një përmirësim prej 10% krahasuar me vitin 2016 (80%).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	3,577,609	3,725,964	3,368,668	3,030,104	3,455,103
Pagat dhe Mëditjet	1,968,980	2,007,448	2,007,448	1,981,127	1,943,181
Mallrat dhe Shërbimet	349,118	371,201	339,606	305,423	400,619
Shërbimet komunale	81,625	81,625	68,718	81,555	96,623
Subvencionet dhe Transferet	2,877	3,069	1,315	3,837	7,700
Investimet Kapitale	1,175,009	1,262,621	951,581	658,162	1,006,980

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore, rishpërndarja e tyre fillestare dhe përfundimtare, si dhe dallimet në shpenzimet që kanë ndikuar në ndryshimet në nivelin e përgjithshëm të shpenzimit janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti përfundimtar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve u rrit me 38,467€ nga Granti i Qeverisë për të shlyer deficitin, për shkak të parashikimeve (supozimeve) buxhetore të pasakta fillestare për këtë kategori;
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime u pasua nga alokimi i të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë prej 22,083€. Buxheti për shërbimet komunale është shpenzuar 84%, edhe pse një vlerë e konsiderueshme e obligimeve kanë mbetur të papaguara;
- Buxheti për subvencione dhe transfere i rritur me të hyrat vetjake të bartura ishte vetëm 3,069€, ndërsa ekzekutimi i tij ishte vetëm 43%;
- Pavarësisht nga buxheti i disponueshëm për shpenzimet kapitale gjatë vitit, është vërejtur një ekzekutim i pamjaftueshëm i buxhetit final për këtë kategori prej 75%. Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar u rrit me 87,612€ si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak. Krahasuar me vitin paraprak, komuna ka treguar shpenzime më të ulëta të këtyre mjeteve për 5%.

Përveç të dhënave të paraqitura në tabelë, Komuna e Shtërpcës ka pasur investime kapitale në shumën totale prej 180,492€ në vitin 2017, financuar nga MAPL në shumën totale prej 67,569€, MKK në shumën totale prej 92,923€ dhe Ministria e Infrastrukturës në shumën totale prej 20,000€.

Çështja 2 – Nivel i ulët i realizimit të buxhetit të investimet kapitale

E gjetura Derisa realizimi i përgjithshëm i buxhetit është në nivel të kënaqshëm, ende vazhdojnë të ekzistojnë shmangieje nga niveli i planifikuar i shpenzimeve. Zbatimi më i ulët në lidhje me investimet kapitale është sfida kryesore me të cilën ballafaqohet komuna. Kjo çështje nuk është adresuar nga menaxhmenti në vitet e fundit, megjithëse është adresuar në raportet e mëparshme të auditimit. Kjo ishte për shkak të mos realizimit të planit për mbledhjen e të hyrave dhe pamundësisë për të financuar projekte me këto fonde, si dhe për shkak të menaxhimit jo adekuat të buxhetit dhe dobësive në hartimin/menaxhimin e projekteve.

Rreziku Planifikimi joadekuat i buxhetit dhe ekzekutimi i tij i dobët do të rezultojë në mos përmbushjen e qëllimeve të organizatës dhe më pak projekte për qytetarët. Nga ana tjetër, dështimi për të përmbushur projektet kapitale mund të rezultojë në financimin e projekteve të vitit aktual nga buxheti i viteve të ardhshme dhe zvogëlimin potencial të Grantit të Qeverisë.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore të monitorohet sistematikisht në baza mujore dhe se ky rishikim identifikon dhe adreson pengesat për zbatimin e buxhetit në nivelin e planifikuar. Këtij aktiviteti duhet t'i paraprijë procesi i duhur i planifikimit, përcaktimit të qëllimeve në raport me buxhetin e komunës.

Çështja 3 - Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve kapitale

E gjetura Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet OJQ-së "FINCH" dhe Komunës së Shtërpcës, është paguar dhe kategorizuar si shpenzime kapitale, nga kodi mirëmbajtja e investimeve, shuma prej 600€ për shtypjen e materialit. Komuna në PFV nuk ka bërë shënime shpjeguese për këto shpenzime.

Rreziku Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve shpie në paraqitje jo të drejtë të shpenzimit në pasqyra financiare, në këtë rast duke mbivlerësuar shpenzimin e kategorisë së investimeve kapitale kundrejt nën shpenzimit të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë se fillimisht është duke u bërë planifikimi i saktë në kategoritë adekuate të shpenzimeve dhe që asnjë shpenzim të mos bëhet pa arsyetimin e duhur.

3.2 Të hyrat

Në vitin 2017, komuna ka grumbulluar 51% të të hyrave të planifikuara vetjake, duke shënuar rënie prej rreth 3% në krahasim me vitin paraprak. Të hyrat e mbledhura nga komuna ishin në shumë prej 228,679€. Shuma me e madhe e të hyrave vjen nga tatimi në pronë (45%), tatimet lidhur me shërbimet e ofruara për tokat, lejet e ndërtimit dhe regjistrimin e automjeteve.

Përveç kësaj, komuna ka pranuar të hyra indirekte në vlerë prej 18,771€ (gjoba të policisë, pylltarisë dhe gjykatave). Përveç rritjes së gjobave të policisë, të hyrat tjera indirekte kanë rënë në mënyrë drastike krahasuar me vitet e kaluara.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	446,914	446,914	228,679	236,832	203,828

Çështja 4 - Mungesa e përditësimit të të dhënave nga tatimi në pronë

- E gjetura** Komuna nuk arriti të verifikojë 1/3 e pronës së regjistruar për tatimin në pronë. Sipas regjistrimit të tatimit në pronë, komuna ka 3,439 objekte të regjistruara të tatimit në pronë, ndërsa në vitin 2017 janë verifikuar vetëm 368 objekte (d.m.th. vetëm 11% e numrit të përgjithshëm të objekteve). Numri i të regjistruarve të rinj në sistem gjatë vitit 2017 është 134, ndërsa numri i tatimpagueseve ekzistues të verifikuar është 234.
- Rreziku** Mos përmbushja e kërkesave ligjore prej 1/3 të verifikimit në baza vjetore, çon në faktin që bazat e të dhënave të tatimpaguesve nuk janë të rregulluara dhe gjithëpërfshirëse, d.m.th. nuk përfshihen të gjithë tatimpaguesit në sistemin e tatimit në pronë, si dhe pronat që janë regjistruar me gabime në bazën tatimore nuk janë azhurnuar. E gjithë kjo ndikon në normën e reduktuar të mbledhjes së tatimit në pronë.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë që komuna të ketë një plan për kontrollin e 1/3-ës të pronës brenda juridiksionit të saj, me qëllim të përcaktimit të taksës sipas barrës reale dhe për të gjitha objektet në territorin e komunës.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF, i cili nuk është i integruar me bazën e të dhënave personale, por megjithatë siguron një sistem efikas kontrolli dhe pagesash që korrespondon me nivelin komunal. Kontrollat e kryera nga komuna kanë të bëjnë me llogaritjen e pagave në pajtim me kontratat e punonjësve dhe ligjet në fuqi. Komuna i përditëson pagat në baza mujore para se të ekzekutohet lista e pagave, ndërsa ndryshimet bëhen me kohë.

Çështja 5 – Parregullsitë në punësim në Departamentin e Arsimit

E gjetura Departamenti Komunal i Arsimit ka shpallur konkurs më 20/07/2017 për të plotësuar vendet e lira të punës për stafin mësimdhënës në vitin shkollor 2017/2018. Konkursi është shpallur për pranimin e arsimtarëve në tri shkolla fillore dhe në një shkollë të mesme, në bazë të të cilit janë pranuar tetë punëtorë.

Duke shqyrtuar dokumentacionin e ofruar, ne kemi gjetur se ka pasur mospajtim me ligjet gjatë hartimit të konkursit dhe kriteret për rekrutimin e mësimdhënësve⁴.

Në dokumentacionin e konkursit mungojnë këto të dhëna të kërkuara me ligj:

- Nuk ka dëshmi se për cilat pozita është shpallur konkursi;
- Nuk është përcaktuar numri i vendeve të punës që kërkohet të plotësohen/ sa punëtor do të rekrutohen;
- Nuk është përcaktuar norma e orëve për secilën pozitë;
- Nuk ka të dhëna/vendim mbi themelimin e një komisioni për përzgjedhjen e stafit mësimdhënës;
- Mungojnë të dhënat/dëshmitë për përzgjedhjen dhe pranimin e kandidatëve; dhe

Në departamentin e shëndetësisë, nga drejtori ekzekutiv i spitalit në Shtërpçë, u shpall konkursi më 28/09/2017 për pozitën shef i parkut të automjeteve. Kontrata është nënshkruar më 23/11/2017, megjithëse spitali nuk është ende funksional.

⁴ Ligji nr. 03/L-212 mbi Punën; Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2011 për rregullimin e procedurave për krijimin e një vendi të punës në sektorin publik, Ligji nr. 04/L-032 mbi Arsimi para universitar në Republikën e Kosovës; Ligji nr. 03/L-068 mbi Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ nr. 17/2009, Procedura për përzgjedhjen e stafit mësimdhënës në shkolla.

-
- Rreziku** Mosrespektimi i ligshmërisë në procesin e rekrutimit rrezikon të drejtën për trajtim të barabartë dhe krijon pabarazi mes konkurrentëve dhe nga ana tjetër mund të krijon favore.
- Rekomandimi 5** Duhet të ndërmerren të gjitha masat që hartimi i konkurseve në të ardhmen të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në mënyrë që të gjithë kandidatët të kenë mundësi të barabarta të punësimit në institucionet arsimore.

3.4 Menaxhimi i personelit

Numri i punonjësve të miratuar nga komuna është 519, ndërsa numri aktual i punonjësve është 397. Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit, dosjet e personelit, kemi shqyrtuar listat e pagave dhe kemi krahasuar informacionet e paraqitura me SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF.

Çështja 6 – Dosjet e pa kompletuara të stafit

- E gjetura** Nga shqyrtimi i 29 dosjeve të personelit, ne kemi identifikuar se asnjë dosje e shqyrtuar nuk është e plotë, pra nuk është në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ 03/2011 (UA). Mungesa e çertifikatave të lindjes, shtetësia, konfirmimi se punonjësit nuk janë nën hetim, si dhe vlerësimi i performancës së punonjësve mungojnë në 51% të dosjeve të shqyrtuara.
- Gjithashtu, zyrtari për evidentimin e dosjeve të nëpunësve civilë ende nuk ka arritur të kryej evidentimin elektronik të nëpunësve të rekrutuar siç kërkohet me Rregulloren Nr. 07/2010 mbi emërimet në shërbimin civil.
- Rreziku** Nuk ka të dhëna të disponueshme me të cilat do të justifikoheshin pagat/shtesat dhe do të mundësohej shqyrtimi i rezultateve të vlerësimit të performancës.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të sigurojë se brenda një periudhe të shkurtër kohore është ndërmarrë një rishikim sistematik i dosjeve të personelit, për të siguruar se ato janë kompletuar me dokumentacioni i nevojshëm.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 371,201€. Prej tyre ishin shpenzuar 339,606€. Ato kanë të bëjnë me furnizim të materialit shpenzues të zyrës, shërbimeve dhe mirëmbajtjes. Rritja e shpenzimeve krahasuar me vitin 2016 është vërejtur në kodet e shërbimeve të tjera të kontraktuara, shpenzimet e telefonit dhe shpenzimet për karburante.

Çështja 7 - Mangësi gjatë prokurimit dhe marrjes së mallrave dhe shërbimeve

E gjetura Komuna ka lidhur Marrëveshjen Publike kornizë për "Mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale në territorin e komunës së Shtërpçës", në vlerë prej 18,054€, pa treguar sasitë indikativë dhe çmimet për njësi. Është negociuar çmimi paushall dhe pagesat janë bërë në bazë të faturave në të cilat nuk janë treguar sasitë aktuale të shërbimeve të kryera, shpenzimet e lëndëve të para (kripa) dhe shumat reale të tyre. Gjithashtu, në raportet e Menaxherit të Projektit nuk janë specifikuar llojet e shërbimeve e as sasia.

Me tutje, komuna ka miratuar një vendim për dhënien e karburanteve për transportimin e nxënësve të shkollës fillore "Anton Santori" në kuadër të kontratës "Furnizim me derivate të naftës për nevojat e Komunës së Shtërpçës", duke shmangur procedurën e prokurimit. Vlera totale e derivateve të dhëna gjatë vitit 2017 ishte 1,533€. Gjithashtu, te kjo lëndë kemi vërejtur se i është bërë pagesa operatorit ekonomik, edhe pse mungon raporti mbi pranimin e shërbimeve.

Rreziku Kjo mund të rezultojë në marrjen e vlerës së ulët për para dhe pagesën e një shërbimi të papranuar.

Rekomandimi 7 Kryetari i Komunës duhet të analizojë arsyet për mos zbatimin e kërkesës së prokurimit. Është e nevojshme të rritet kontrolli efektiv gjatë hartimit të kërkesave, specifikimeve, para-matjeve dhe vlerësimeve, si dhe të përcaktohen qartë të gjitha pozicionet e punëve ose shërbimeve në mënyrë që të eliminohen pagesat e pa rregullta. Të ndërmerren kontrole që sigurojnë që pagesat janë në përputhje me shërbimin e ofruar.

Çështja 8 - Angazhimet me marrëveshje për shërbime të veçanta pa procedura të rekrutimit

E gjetura Komuna vazhdon të angazhojë stafin përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, të cilat angazhohen pa procedura të rekrutimit. Gjatë vitit 2017 janë angazhuar gjashtë punëtorë me marrëveshje përmes shërbimeve të veçanta dhe shuma e paguar për këto shërbime gjatë vitit 2017 është 10,202€, duke përfshirë edhe pagesat sipas kontratës se vitit 2016. Kohëzgjatja e tyre në tri raste i ka tejkaluar afatet e lejuara me ligj. Të gjashtë punëtorët janë të angazhuar në pozita për të cilat nuk kërkohet ekspertiza e veçantë, tri pozita të rojeve të pyllit dhe tri

pozita të inspektorit komunal. Gjithashtu, në një rast, kemi vërejtur se pagesa tejkalonte 460€ më shumë se shuma e kontraktuar.

Rreziku Angazhimi i punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta duke shmangur procedurat e rekrutimit, minimizon konkurrencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat në pozita të caktuara. Ndërsa tejkalimi i kohëzgjatjes së këtyre kontratave për më shumë se gjashtë muaj, është në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se gjashtë muaj. Për të gjitha pozitat e rregullta të punës duhet të sigurohet se buxhetohen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve si dhe paguhen nga sistemi i pagave.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 3,069€, që është vetëm 1% e buxhetit të përgjithshëm komunal. Shpenzimet e këtyre mjeteve ishin 1,315€ dhe kishin të bëjnë me entitetet jo publike. Nga kjo kategori ne testuam pesë pagesa dhe ne shqyrtuam nëse ato ishin dhënë në përputhje me legjislacionin.

Çështja 9 – Mungesa e raporteve kthyese nga përfituesit e subvencioneve

E gjetura Gjatë shqyrtimit të pesë rasteve të dhënies së ndihmës financiare nga komuna, ne kemi konstatuar që kontrollet e brendshme nuk ishin funksionale. Në fakt, kemi vërejtur mungesë të informatave kthyese nga përfituesit e subvencioneve, gjë që është në kundërshtim me nenin 23 të Rregullores së Brendshme për subvencionet.

Rreziku Mungesa e informatave kthyese (feedback) për shpenzimin e mjeteve të ndara e shkakton rrezikun që mjetet të mos jenë shpenzuar për qëllimet për të cilat edhe janë ndarë.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në mënyrë që mjetet e ndara nga komuna në emër të subvencioneve të justifikohen në mënyrë adekuate.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 1,262,621€. Prej tyre në vitin 2017 ishin shpenzuar 951,581€. Shpenzimet në vlerë prej 421,327€ ose 44% janë regjistruar në kodin për mirëmbajtjen e investimeve. Duke testuar pagesën për investime kapitale, ne kemi identifikuar mangësitë si më poshtë:

Çështja 10 - Pagesat për projektet e bashke financuara

E gjetura Komuna ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi për bashkëfinancimin e disa projekteve dhe ne kemi gjetur si në vijim:

Komuna ka lidhur marrëveshje të bashkëfinancimit me (UNDP Kosovë) për zbatimin e projektit "Zhvillimi i Integruar Territorial 2" të financuar nga Programi Austriak për Zhvillim dhe Bashkëpunim (ADC) përmes ndihmës për ekonominë familjare bujqësore të cilat merren me prodhimin e mjedrës dhe mjaltit. Në marrëveshje është dakorduar për pjesëmarrjen e komunës në këtë projekt në vlerë prej 90,000€, për një periudhë prej tri vitesh, me një paradhënie prej 30,000€ pas nënshkrimit të memorandumit. Komuna ka paguar këstin e kontraktuar më 13/09/2017, nga kategoria e investimeve kapitale gabimisht në kodin mirëmbajtje investive, dhe pa raport të pranimit dhe faturë që do të konfirmonte kundërvlerën e këtyre shpenzimeve.

Komuna më pas, ka pranuar "Raportin për realizimin e kontributit financiar të Komunës së Shtërpçës (2017)" të bërë më 21/03/2018 nga UNDP, i cili përmban një listë të kultivuesve të mjedrës dhe bletarëve, përfituesit e mjeteve dhe pajisjeve si dhe raportin financiar. Megjithatë, ky raport nuk ofron dëshmi për pranimin real të mallit nga përfituesit, nuk ka nënshkrim të përfituesit, përshkrim/sasi të mallit që ka pranuar, nuk ka të bashkangjitur ndonjë faturë që justifikojnë këto shpenzime. Në mungesë të monitorimit nga ana e komunës, nuk është e qartë nëse projektet janë përfunduar në cilësinë e pritshme dhe nëse është marrë vlera për para.

Rreziku Pagesat bazuar në marrëveshjet e mirëkuptimit/bashkëpunimit nuk kanë një bazë të qartë ligjore për ekzekutimin e shpenzimeve, sepse rregullat financiare nuk e njohin një mënyrë të tillë shpenzimi. Duke pasur parasysh se komuna nuk ka mekanizma të garancisë/sigurisë, se marrëveshjet do të zbatohen ashtu siç është vendosur, ekziston një rrezik real që marrëveshjet mos të realizohen, që qëllimet të mos arrihen dhe fondet e shpenzuara të mos kthehen.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë që planifikim fillestar është bërë sipas kodeve adekuate të shpenzimeve dhe se asnjë shpenzim të mos bëhet pa një justifikim të duhur. Të gjitha pagesat duhet të mbështeten me dëshmi. Duhet të sigurojë se do të shtohen kontrollet për zbatimin të këtyre marrëveshjeve, në veçanti duke kërkuar raporte periodike nga partnerët në lidhje me progresin e bërë kundrejt fondeve të shpenzuara. Komuna duhet të përgatisë raporte përfundimtare për ekzekutimin e projekteve të financuara më parë.

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 11 - Menaxhimi i dobët i kontratave

E gjetura

Shqyrtimi i mostrave shpalosi mangësitë e mëposhtme:

- Pagesa në vlerë prej 167.5€ për furnizim me material për zyrë⁵ nuk është bërë në bazë reale, janë faturuar mallrat e pa kontraktuara si rezultat i menaxhimit jo adekuat të kontratës (59€);
- Komuna edhe pse ka kontraktuar sasi të indikativë të mallrave për furnizim me material zyrtar, nuk ka raporte përmbledhëse nga Menaxheri i projektit, respektivisht në raporte nuk paraqitet gjendja e sasisë së artikujve të blerë krahasuar me artikujt e parashikuar sipas ofertës;
- Në bazë të Marrëveshjes Kornizë Publike "Rehabilitimi dhe rregullimi i infrastrukturës në territorin e Shtërpcës" të nënshkruar më 12/12/2016, gjatë vitit 2017, është paguar shuma prej 343,831€ ose 50% e shumës së kontraktuar. Siç është theksuar në raportin e auditorit për 2016, në specifikacionet teknike të punës nuk janë përcaktuar rrugët që do të sanohen. Përveç kësaj, pranimi i punimeve nuk është kryer në bazë të një situacioni përmbledhës që përfaqëson në mënyrë progresive vëllimin e punëve të përfunduara, gjë që do të thotë se çdo situacion përmban vëllimin e punëve të përfunduar vetëm gjatë periudhës së raportimit;

⁵ Marrëveshjes Publike Kornizë "Furnizimi me material të zyrës për nevojat e komunës së Shtërpcës dhe material të zyrës dhe pajisje tjera për nevojat e shkollave në territorin e komunës së Shtërpcës", në vlerë prej 16,659€ dhe kontratës tjetër për të njëjtin qëllim në vlerë 35,000€.

- Te kontrata "Ndërtimi i një muri mbështetës në sheshin e lojërave në shkollën e fshatit Brod", komuna ka bërë pagesën totale të vlerës së kontraktuar bazuar në raportin e menaxherit. Me ekzaminimin fizik konstatuam se pozicioni "Përforcim me rrjetin e armaturës Q335 dhe betonimin e pllakës së stadiumit me lidhje në trashësi $t = 20\text{cm}$ " të vlerës së specifikuar prej 680€, nuk ishte realizuar. Ne kemi marrë dëshmi për realizimin e pozicionit të lartcekur, pas përfundimit të auditimit; dhe
- Me Kontratën Publike Kornizë "Rindërtimi i Shkollave Filllore dhe të Mesme në Territorin e Shtërpçës" me vlerë 165,490€, menaxheri i kontratës, i cili përveç që nuk kishte kualifikime përkatëse në fushën e ndërtimit, ishte i përfshirë në gjithë procesin, përfshirë pranimin e punëve/shërbimeve si dhe ekzekutimin e pagesave.

Rreziku

Dobësitë në menaxhimin e kontratave, gjegjësisht mungesa e raportimit cilësor në lidhje me zbatimin e kontratës, zvogëlojnë sigurinë që kontratat të zbatohen në përputhje me kushtet dhe specifikimet e parapara. Mos planifikimi i dinamikës së shpenzimeve mund të rezultojë në mos efikasitet në realizimin e kontratave në raport me fondet e shpenzuara.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të sigurojë respektim të konsistencës/qëndrueshmërisë të rregullave/procedurave të prokurimit, si dhe menaxhim adekuat të kontratave për të siguruar arritjen e vlerës për paratë e shpenzuara për prokurim. Mbikëqyrja sistematike e zbatimit të kontratës do të rriste sigurinë për zbatimin e tyre në përputhje me kushtet e kontraktuara.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pronës është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura kontrolli dhe menaxhimi që konfirmojnë ekzistencën e pronës dhe sigurojnë të dhëna të sakta dhe të përditësuara në lidhje me pasuritë e institucionit.

Komuna ende nuk ka arritur të ofrojë një regjistër të përgjithshëm dhe të plotë të pasurisë jo-financiare. Sfidat e regjistrimit dhe vlerësimit të pasurive kanë rezultuar me një nënvlerësim material të vlerës së pasurisë në PVF, veçanërisht ato që lidhen me tokën.

Ne testuam gjendjen fillestare, blerjet gjatë vitit të pasurisë duke përfshirë investimet kapitale, si dhe blerjet e pajisjeve, mobile në shumën nën 1,000€ nga mallrat dhe shërbimet, si dhe korrigjimin në regjistrimin e pronës që është në dispozicion. Ne gjithashtu kryem një kontroll fizik në mënyrë që të konfirmojmë ekzistimin e pronës.

Çështja 12 - Dobësitë në menaxhimin e pasurisë

- E gjetura** Komuna ende nuk ka procedurë të brendshme për menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat e Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Komisioni i themeluar për vlerësimin e pasurive ka kryer vetëm verifikimin e pasurisë ekzistuese, e jo edhe vlerësimin e pasurive të vjetruara që nuk përdoren më ose tjetërsimin e tyre. Si pasojë, në regjistrin e pasurisë është ende e regjistruar pasuria e tjetërsuar, pajisje mjekësore në vlerë 13,020€.
- Komuna gjithashtu krijoi një komision për inventarizimin e pasurive që kryen vetëm identifikimin e pjesshëm të pasurisë jo financiare.
- Rreziku** Mungesa e procedurave të menaxhimit të brendshëm rrit rrezikun që komuna të mos ketë kontroll mbi të gjithë pronën dhe të mos jetë në gjendje të gjenerojë raporte të sakta lidhur me pasurinë. Komisionet përkatëse duhet të përgatisin raporte përfundimtare mbi gjendjen e pasurisë, në mënyrë që të shmanget rreziku i keqpërdorimit ose humbjes së pasurisë.
- Rekomandimi 12** Kryetari duhet të iniciojë procesin e hartimit të rregulloreve të brendshme në lidhje me regjistrimin e pasurisë dhe të sigurojë që janë zbatuar të gjitha kërkesat në lidhje me procedurat e inventarit të plotë dhe vlerësimit të pasurisë komunale në fund të vitit. Duhet të përgatiten raporte dhe rezultate të inventarizimit që do të përfshihen në PVF.

3.10 Të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet këtë vit tregojnë trendin e rritjes së këtyre llogarive për shkak se komuna ka paraqitur të arkëtueshme në vlerë prej 1,844,000€, krahasuar me 1,664,000€ në vitin paraprak. Kjo ndodh për shkak të politikave joefektive që janë zbatuar nga menaxhmenti dhe mungesës të një strategjie për mbledhjen e tyre.

Pjesa më e madhe e të arkëtueshmeve ose mbi 90% janë nga tatimi në pronë. Sistemi i tatimit në pronë është i centralizuar në një bazë të dhënash të pronës tatimore që përmban informacion për të gjitha komunat në Kosovë dhe mirëmbahet nga Departamenti i Tatimit të Pronës në MF. Secila komunë është e detyruar të menaxhojë futjen e informacionit të tatimit në pronë në bazën e të dhënave, me të gjitha informatat, përfshirë tatimin në pronë, adresat e pronës, adresat e pronarëve dhe përdoruesve, të dhënat e tokës dhe ndërtesave, vlerat e pronës, shkallen e tatimit, detyrimet tatimore dhe të dhënat e pagesave tatimore.

Çështja 13 - Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme

E gjetura Menaxhimi jo adekuat i informatave nga tatimi në pronë në kuadër të bazës së të dhënave nga ana e komunës ka sjell deri te një dallim në mes të të dhënave të gjeneruara nga komunës dhe MF për gjendjen reale të llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë.

Me gjithë përpjekje të vazhdueshme për të mbledhur të arkëtueshmet nga tatimi në pronë (1,670,000€), ato vetëm se janë duke u rritur nga viti në vit kjo për shkak se gjatë vitit 2017 janë mbledhur vetëm 104,312€ ose 6% e të hyrave të faturuar. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, komuna ka rënie të inkasimit gjatë vitit 2017 deri në 16%. Gjithashtu, një nder shkaktaret për rritjen e llogarive të arkëtueshme për tatimin në pronë ka qenë edhe me mos pagesa e obligimeve nga ndërmarrjet shoqërore (NSH) para privatizimit të tyre dhe/ose likuidimit.

Të arkëtueshmet në emër të taksave të biznesit janë në rritje drastike, pasi në vitin 2017 komuna nuk ka mbledhur ndonjë shumë në emër të këtyre të hyrave.

Rreziku Mungesa e mekanizmave dhe kontrolleve adekuate rrit rrezikun e rritjes së vazhdueshme të këtyre llogarive, duke rezultuar më me pak fonde për arritjen e qëllimeve, si dhe inkurajon debitorët tjerë që të mos paguajnë detyrimet e tyre.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të analizojë arsyet për trendin në rritje të llogarive të arkëtueshme të tatimit në pronë dhe të forcoj kontrollet për të parandaluar rritjen e tyre të mëtejshme. Duhet të krijohet një strategji dhe mekanizëm për të mundësuar identifikimin dhe grumbullimin e të arkëtueshmeve të akumuluarra përmes futjes së kushtëzimit të disa shërbimeve komunale bazuar në dëshmitë/evidencat për pagesën e tatimit në pronë të paguar. Gjithashtu, është e nevojshme që komuna të menaxhojë siç duhet llogaritë e arkëtueshme në emër të taksës për biznesin.

3.11 Obligimet e papaguara

Obligimet komunale paraqesin detyrime ndaj furnizuesve, të cilat janë bartur për pagesë në periudhën në vijim. Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 45,466€, e cila në krahasim me vitin paraprak paraqet trend të rritjes, për 23,466€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Obligimet e papaguara lidhen me shpenzimet për mallra dhe shërbime, komunalit dhe investime kapitale.

Përveç obligimeve të rregullta, komuna gjithashtu ka detyrime kontingjente në lidhje me raste të ndryshme gjyqësore, në vlerë rreth 9,000€, të cilat krahasuar me një vit më parë (6,180€) paraqesin tendencë të rritjes.

Çështja 14 - Vonesa në pagesën e faturave

E gjetura Të gjitha faturat e dorëzuara në komunë duhet të paguhen brenda 30 ditëve. Megjithëse sipas të dhënave të komunës nuk ka pasur vonesa në pagesa (pranime) gjatë vitit, në fund të vitit fiskal nga totali i detyrimeve, 17 faturat në vlerë prej 10,346€ janë më të vjetra se 30 ditë. Kjo është në kundërshtim me Rregullën Financiare nr. 01/2013/MF "Shpenzimi i parave publike". Këto detyrime janë bartur për të paguar në vitin 2018 si një barrë shtesë buxhetore. Arsyeja kryesore për mosekzekutimin në kohën e detyrimeve, sipas zyrtarëve përgjegjës, ishte vonesa në pranimin e faturës.

Rreziku Si pasojë e hyrjes në obligime financiare të pambuluara, mund të dobësohet aftësia për të planifikuar menaxhimin e nevojave për likuiditet dhe komuna mund të përballlet me shpenzime shtesë, kamatat dhe gjobat për vonesat e bëra ndaj palëve.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të sigurojë masa konkrete që departamenti i financave evidenton dhe paguan të gjitha detyrimet në kohën e duhur, ndërsa detyrimet potenciale duhet të trajtohen me kujdes gjatë planifikimit të ardhshëm të buxhetit.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të komunës së Shtërpcës ka rezultuar në 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Megjithatë, edhe pse raporti i AP-së i ishte prezantuar Kuvendit Komunal, kuvendi nuk e ka diskutuar dhe as nuk ka kërkuar nga komuna që të monitorojë zbatimin e rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, katër rekomandime janë zbatuar; gjashtë janë në proces të zbatimit, ndërsa pesë nuk janë zbatuar ende. Nga viti 2015, ende nuk janë zbatuar tri (3) rekomandime, ndërsa shtatë (7) ende janë në proces të zbatimit. Për një përshtetje më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 15 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Për shkak të menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Ne nuk kemi vërejtur se komuna aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, kanë rezultuar në:

- Menaxhim të dobët me pasurinë e komunës;
- Dobësi në procedurat e rekrutimit;
- Regjistrimi i shpenzimeve në kode të gabuara ekonomike;
- Menaxhimi joadekuat i të arkëtueshmeve.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit. Rekomandimet nga vitet e mëparshme duhet gjithashtu të zbatohen sa më parë që të jetë e mundur.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me kualitetin e raportit menaxherial dhe menaxhimin e rrezikut. Pyetësi i vetëvlerësimit, i cila plotësohet nga komuna, e reflekton këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistencën e formave aktuale të qeverisjes që nuk mbështeten në dëshmi. Masat tjera që nuk janë vendosur plotësisht dhe do të mbështesnin zhvillimin e qeverisjes do të ishin një reagim efektiv ndaj rekomandimeve të auditimit dhe funksionimit të një sistemi të auditimit të brendshëm të cilësisë së lartë.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një auditor i cili është Drejtor i njësisë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv i Auditimit.

Përveç Planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe Planin vjetor të punës ku ishin përfshirë gjashtë auditime për vitin 2017. NjAB kishte përfunduar të gjitha auditimet e planifikuara, në të cilat kishte ofruar 24 rekomandime.

Raportet e auditimit të brendshëm janë përgatitur nga NjAB dhe janë dorëzuar rregullisht në menaxhment sipas një plani vjetor të aprovuar. NjAB ka raportuar vazhdimisht përmes raporteve tremujore dhe vjetore mbi aktivitetet e auditimit të brendshëm.

Çështja 16 – Dobësitë në auditimin e brendshëm

- E gjetura** Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së, si:
- Menaxhmenti komunal nuk ka përgatitur një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të NjAB dhe kjo ka rezultuar në përsëritjen e çështjeve të rekomanduara;
 - Rekomandimet e auditimit të brendshëm janë zbatuar vetëm në një numër të vogël të rasteve; dhe
 - Komiteti i Auditimit nuk ka qenë plotësisht funksional gjatë vitit 2017 për shkak të formimit të tij më vonësë.
- Rreziku** Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e përkushtimit të Menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm që e rrit rrezikun që kontrollet e brendshme të vendosura nga ana e menaxhmentit nuk funksionojnë në mënyrë efektive dhe të mos identifikohen dobësitë në sisteme.
- Rekomandimi 16** Kryetari duhet të ndërmarrë veprime konkrete për përgatitjen e një plan veprimi në lidhje me rekomandimet e NjAB dhe të kërkojë nga zyrtarët përgjegjës të cilëve u janë drejtuar rekomandimet për të raportuar mbi kërkesën formale lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Auditimi ynë i kontrolleve menaxhuese vuri në dukje raportimin e dobët financiar të menaxhmentit në lidhje me shpenzimet, si dhe analizën e pa kompletuar të ofrimit të shërbimeve. Forma e raporteve menaxheriale, siç është raporti i pronës, nuk jep sqarime reale për pronën e zotëruar dhe përditësuar brenda vitit. Drejtorët e departamenteve, siç janë: drejtori i prokurimit, stafi dhe financat, nuk raportojnë në baza javore ose mujore te kryetari. Forma e vetme e raportimit është ajo verbale. Po aq e rëndësishme është ndarja e detyrave të stafit, ku një zyrtar është përgjegjës për më shumë se një detyrë, dhe kjo është për shkak të mungesës së stafit. Llogaridhënia efektive kërkon të qartësojë rolet dhe përgjegjësitë.

Çështja 17 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

- E gjetura** Pyetësi i vetëvlerësimit i plotësuar nga Komuna ka konfirmuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut ende nuk janë funksionale. Deri te kjo situatë ka ardhur për shkak se komuna nuk ka përgatitur një plan rreziku dhe nuk ka analizuar procedurat për identifikimin e këtyre rreziqeve për institucionin.
- Rreziku** Mos identifikimi dhe analizimi i rreziqeve në mënyrë adekuate zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për t'iu përgjigjur në kohë dhe në mënyrë korrekte sfidave, pavarësisht nëse ato janë financiare apo operacionale.
- Rekomandimi 17** Kryetari duhet të sigurojë që të përpilohet një listë e rreziqeve të mundshme dhe të përcaktojë masat dhe personelin përgjegjës për të menaxhuar këto rreziqe.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4. Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet që kanë ndikuar në modifikim të opinionit apo theksim të çështjes për t'i hequr gabimet e pagesave të parregullta, klasifikimin e shpenzimeve si dhe për mos regjistrim të plotë të pasurisë dhe regjistrimin e pagesave nga palët e treta në SIMFK.		Komuna ka përmirësuar çështjen e raportimit të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike, mirëpo çështja e pasurive ende është në procesin e zbatimit.	
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të monitoroj në mënyrë sistematike zbatimin e planit të veprimit dhe të identifikoj arsytet pse i njëjti nuk është zbatuar. Një plan i rishikuar duhet të përcaktoj saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, dhe stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Është hartuar Plani i Veprimit, por nuk i ka listuar personat përgjegjës, si dhe masat specifike për zbatimin e rekomandimeve	
2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit -	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	Po		
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është hartuar lista e rreziqeve potenciale dhe është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet.			Nuk janë marrë masa.

2.5.2 Plani Zhvillimor	Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.			Nuk janë marrë masa.
Mungesa e Komitetit të Auditimit	Kryetari duhet të fuqizoj rolin dhe rëndësinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Ne do të sugjeronim që më së largu deri në fund të vitit 2016, të themelohet Komitetin e Auditimit të Brendshëm.	Po		
3.3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Kryetari duhet të siguroj që të hyrat vetjake të përdorën për investime kapitale, ashtu siç janë aprovuar me buxhet.		Performanca e buxhetit monitorohet, mirëpo të ardhurat vetjake kryesisht janë shpenzuar për mallra dhe shërbime.	
3.4 Prokurimi	Kryetari duhet të sigurojë se janë marrë veprime konkrete për shpenzim të buxhetit vetëm për blerjet e nevojshme gjatë vitit si dhe mos të autorizoj blerjet për shëndetësi sekondare për pajisjet të cilat nuk mund të përdoren derisa spitali fillon të funksionojë.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi (çështja 7)	Kryetari i Komunës duhet të merr masa të menjëhershme për ta analizuar procesin, që nga inicimi i procedurave të prokurimit, lidhja e kontratës, e deri te zbatimi i punimeve të parashikuara me kontratë. Me fokus të veçantë duhet të shqyrtohen ndikimet e çmimeve jo normalisht të ulëta të ofruara nga operatori dhe të bëhen vlerësimet e kostove deri në realizimin përfundimtar të kontratës. Gjithashtu, vonesat në realizimin e projektit duhet të shqyrtohen dhe të merren masa që projekti të kryhet sa më parë.		Komuna ka ndërmarr masa për të përfunduar projektin. Projekti është në fazën përfundimtare.	

3.4 Prokurimi (çështja 7)	Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet me rastin e pranimit të mallit, dhe të formoj komisionet përkatëse për të konfirmuar se mallrat janë pranuar sipas cilësisë dhe sasisë së paraparë me kontratë.	Po		
3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari duhet të sigurojë se kjo çështje do të analizohet dhe të merren në konsideratë kërkesat ligjore për pagesën e këtyre të punësuarve, në mënyrë që të mos të dëmtohet buxheti i komunës.		Komuna i ka të angazhuar këta punëtor në programe tjera.	.
3.6 Të hyrat	Kryetari të siguroj që gjatë planifikimit vjetor të buxhetit të analizoj trendin e të hyrave në tri vitet e kaluara, si dhe të ketë në konsiderim bazën aktuale të ngarkesave me taksat dhe tatime. Po ashtu, të rishqyrtoj politikat ekzistuese dhe të propozoj masat e duhura që të gjitha bizneset që veprojnë në territorin e komunës, të pajisen me lejet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe të paguajnë taksat komunale.		Është bërë analiza e trendit të mbledhjes së të hyrave, por ende nuk janë marrë masa për të mbledhur taksat për biznesin.	
3.7.3 Pasuritë	Kryetari duhet t'i zbatoj me konsekuencë kërkesat dhe procedurat formale, të parapara me rregullore të brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare.	Po		
3.7.3 Trajtimi i të Arkëtueshmeve	Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike çështjen e realizimit të të hyrave, për të siguruar se politikat dhe masat adekuate do të ndërmerren për të maksimizuar inkasimin e borxheve. Është e nevojshme që të bëhet një analizë e detajuar që përcakton arsyet e ngecjes së pagesave, si dhe të propozohen veprimet konkrete dhe burimet e nevojshme për mbledhjen e këtyre borxheve.		Është zbatuar pjesërisht, pasi komuna ka ndërmarr disa aktivitet për regjistrimin e pronave të reja për tatimim.	

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Raportet financiare	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabimet.		Rekomandimi është zbatuar pjesërisht për shkak se një pjesë e pasurisë ende mbetet e paregjistruar në regjistrat përkatës.	
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë hartimin e një plani të qartë të veprimit, duke i përcaktuar personat përgjegjës për procesin, masat dhe veprimet specifike, si dhe afatet kohore për zbatimin e planit. Monitorimi i këtij plani duhet të bëhet të paktën çdo tremujor si dhe të zbatohet një proces rigoroz i llogaridhënies në rast të ngecjeve dhe mos realizimit të këtij plani.		Ende nuk janë zbatuar të gjitha rekomandimet e bëra nga ZKA. Plan i veprimit është hartuar, por nuk specifikon personat përgjegjës, as masat specifike për zbatimin e rekomandimeve.	
2.2 Pyetësi i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se do të hartohet lista e rreziqeve dhe plani strategjik. Monitorimi i strategjisë duhet të bëhet në baza të vazhdueshme për tu siguruar se objektivat strategjike janë duke u arritur. Njësia e auditimit të brendshëm duhet të angazhohet për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese..			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes	Kryetari duhet të hartoj planet strategjike dhe të vendosë objektiva të qarta të zhvillimit në gjithë sektorët e komunës, si dhe të njëjtat të monitorohen në mënyrë sistematike për të vlerësuar planifikimet fillestare dhe progresin në arritjen e objektivave në periudhat e caktuara.			Nuk janë marrë masa.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ dhe të bëhen raportimet mujore me shkrim nga drejtorët tek menaxhmenti.		Janë marrë masa, por ende nuk ka dëshmi të qarta se ky rekomandimi po zbatohet në tersi.	
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se janë rritur masat e përgjegjësisë ndaj të gjithë zyrtarëve përgjegjës për zbatimin me kohë të rekomandimeve të AB, dhe të siguroj se është bërë hartimi i statutit të NjAB dhe komitetit të auditimit.		Është hartuar Statuti i NjAB, por nuk janë ndërmarrë masa ndaj të gjithë zyrtarëve përgjegjës për zbatimin në kohë të rekomandimeve të NjAB.	
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që planifikimi, performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj e me rastin e planifikimit të të hyrave nga tatimi në pronë do të merret parasysh trendi i inkasimit të periudhave të mëparshme dhe të siguroj se verifikimi i pronave komunale bëhet në baza të rregullta vjetore, siç parashihet me ligj.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj që të hyrat e mbledhura përmes arkës të deponohen në bankë brenda afateve të përcaktuara me rregulloren për të hyra vetjake.		Janë vërejtur përmirësime, por të hyrat nuk depozitohen në baza ditore në bankë.	
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të siguroj se mjetet të cilat i janë paguar më shumë se sa lejohen, të kthehen në buxhetin e komunës nga e punësuarja, dhe të forcoj kontrollet e pagesave që rastet e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.	Po		

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, dhe shërbimet komunale	Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur kontrollet e duhura të certifikimit të pagesave në mënyrë që asnjë pagesë mos të bëhet më shumë sesa shumat e faturuara. Komuna duhet ta shqyrtoj rastin pse mbi pagesat e mësipërme kanë ndodhur dhe të njëjtat, ose t'i kthehen komunës, ose të trajtohen si paradhënie ndaj operatorit furnizues me rrymë elektrike.	Po		
Prokurimi	Kryetari duhet të siguroj se janë të vendosura kontrollet e brendshme dhe funksionale me qëllim të parandalimit të shpërblimit me kontrata OE të cilët nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit. Më tej, komuna duhet të ndërpres dhënien e dhuratave në fund vit për stafin komunal, sepse kjo nuk është në pajtim me ligjin.	Po		
3.1.5 Investimet kapitale	Kryetari duhet të siguroj që zyra e prokurimit përgatit dosjet e tenderit sipas kërkesave të rregulloreve të prokurimit dhe specifikon qartë sasinë dhe njësitë e përafërta indikative të punëve. Dosjet e qarta të tenderit do të rrisin edhe parimin e transparencës dhe konkurrencës në procesin e prokurimit.	Po		
3.2 Pasuritë	Kryetari duhet të rishikoj proceset e vlerësimit/regjistrimit të pasurive komunale në mënyrë që të sigurohet se të gjitha pasuritë janë regjistruar në regjistrin e pasurive dhe janë prezantuar drejtë në PVF.			Nuk janë marrë masa.
3.2.2 Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të sigurojë iniciimin e një procesi të rivlerësimit, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë dhe mundësive reale për inkasim, dhe të propozoj masa konkrete, duke mos i përjashtuar edhe masat administrative dhe të tjera (nëse ka nevojë).		Komuna ka bërë përpjekje për evidentimin e pronave të reja tatimore, mirëpo ende duhet të aplikohen masa për menaxhimin adekuat të të arkëtueshmeve.	

Shtojca III: Letër konfirmimi

	<div style="border: 1px solid black; padding: 5px; width: fit-content; margin: 0 auto;"><p style="margin: 0;">REPUBLICA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS</p><p style="margin: 0;">03/Br.Pis. IZLAZHI - DALËSE Nr.Prof. 02-050101-6873/18 Br.str. 1 Nr.l fq. Datum: 30.05.2018 Data</p><p style="margin: 0; text-align: center;">ŠTRPCE - SHTËRPCË</p></div>	
<p>Република Косово-Република е Kosovës-Republic of Kosovo</p> <p>Општина Штрпце / Komuna e Shtërpçës / Municipality of Strpce</p>		
<p>POTVRDNO PISMO</p>		
<p>O saglasnosti sa nalazima Generalnog Revizora na Izveštaju revizije za 2017 godinu kao i za sprovođenje preporuka</p>		
<p>Za: Nacionalnu Kancelariju Revizije:</p>		
<p>Poštovani,</p>		
<p>Preko ovog psima, potvrđujem da:</p>		
<ul style="list-style-type: none">• sam primio nacrt izveštaja Nacionalne Kancelarije Revizije o Reviziji Finansijskih Izveštaja opštine Štrpce za godinu završno sa 31 decembrom 2017 (u daljem tekstu "Izveštaj");• se slažem sa nalazima i preporukama i nemam neki komentar u vezi sa sadržajem izveštaja; i da ću• u roku od 30 dana od prijema Završnog izveštaja, dostaviti akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će uključiti vremenske rokove i osoblje koje je odgovorno za njihovo sprovođenje.		
<p>g .Bratislav Nikolić, Predsednik Opštine</p>		
<p>Datum: 30. Maj 2018. Strpce</p>		